



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : “Konsultim për zgjedhjen e komisioneve të këshillit”

Propozuesi: Kryetari i Këshillit Bashkiak.

Qëllimi: Ky bashkëbisedim ka për qëllim të përfshijë grupet shoqërore në vendimmarrje për shërbime të mira.

Sqarime: Këshilli i Bashkisë do të organizoj këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi zgjedhjen e komisioneve të këshillit.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Durrës, në datë **30.06.2023, ora 12:00**.

Pjesëmarrës:

- **Nga ana e Bashkisë:** Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Koordinator i Njoftimit dhe Konsultimit Publik.
- **Nga komuniteti:** Banorët e Bashkisë Durrës, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias.

Forma e konsultimit: Takim në terren.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik në terren synon për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi zgjedhjen e komisioneve të këshillit .
	Komisionet e Këshillit janë të Përhershëm ose të Përkohshëm dhe përbëhen nga Këshilltarë Bashkiakë . Komisionet e Përhershme kanë juridiksion të vazhdueshëm mbi një apo disa çështje që ka lidhje me funksionet e Bashkisë.Komisionet e

<p>Përshkrimi i çështjes.</p>	<p>Përhershëm të Këshillit janë komisione statutorë (të kërkuar nga ligji) dhe jo-statutorë. Komision statutorë është Komisioni i Mandateve. Komisionet e Përhershëm jo-statutorë janë komisionet që përcaktohen nga Këshilli Bashkiak sipas fushave të veprimtarisë së Bashkisë dhe prioriteteve të Këshillit.</p> <p>Objekt i punës së Komisioneve është diskutimi i projekteve, rezolutave, deklaratave, politikave dhe mbikqyrja e punës së Ekzekutivit të Bashkisë, të institucioneve, ndërmarrjeve dhe agjencive në vartësi të Bashkisë, si dhe marrja e informacionit, mendimeve të tyre, si dhe për të dëgjuar komentet, propozimet, vërejtjet e qytetarëve, shoqërisë civile dhe biznesit.</p> <p>Për këtë, Këshilli i Bashkisë do të organizoj këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi zgjedhjen e komisioneve të këshillit .</p>
<p>Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve</p>	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në ditën e mbajtjes së takimit</p>
<p>Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme</p>	<p>Opsionet e mundëshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit :</p> <p>Ndryshime dhe/ose alternativat e mundshme në zgjedhjen e komisioneve të këshillit.</p>
<p>Dokumentacioni, në lidhje me çështjen që konsultohet.</p>	<p>Materialet mbi të cilin kërkojmë komentet apo sugjerimet tuaja i gjeni ne linkun: https://durrës.gov.al/keshilli-bashkiak/</p> <p>Këshilli i Bashkisë ka 14 (katërmëdhjetë) Komisione të Përhershme të emëruara si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Komisioni i Mandateve, 3 anëtare/ë 2. Komisioni i Rregulloreve, Çështjeve Juridike, 5 anëtare/ë 3. Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, 11 anëtare/ë 4. Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, 9 anëtare/ë 5. Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë, 5 anëtare/ë 6. Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, 5 anëtare/ë 7. Komisioni për Marrëdhënjet me Jashtë, 7 anëtare/ë 8. Komisioni i Mjedisit dhe Trajtimit të Mbetjeve, 7 anëtare/ë 9. Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale, 5 anëtare/ë 10. Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, 7 anëtare/ë 11. Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, 7 anëtare/ë 12. Komisioni i Politikave të Zhvillimit Ekonomik, 7 anëtare/ë 13. Komisioni i Politikave të Zhvillimit të Turizmit, 7 anëtare/ë 14. Komisioni i Etikës, Apelimeve, Konfliktit të Interesit, Peticioneve, 7 anëtare/ë